Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Zyra e Drejtorit/ Kancelarija Direktora /Office of the Director

Numër:33/02
Datë: 18.02.2014

Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), mbështetur në nenin 142, me të gjitha pikat të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 5, 10, 11, 14 dhe 15 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare, nenin 50 të Ligjit nr. 03/L- 189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 26 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, nxjerrë :

VENDIM

1. Shfuqizohet vendimi i drejtorit të AKK-së nr. 684/13 i datës (04.10.2013) për organizimin e seminareve sipas nevojës për ofruesit e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe angazhimin e ekspertëve për këto ngjarje .

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Duke marrë parasysh që për organizimin e seminareve dhe punëtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave që dalin nga ligji për kualifikimet Kombëtare nuk angazhohen gjithmonë ekspertë të jashtëm, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Zyrës për buxhet dhe financa
2. Zyrës së Drejtorit të AKK
3. Stafit të AKK-së
4. Arkivit.

Teuta Danuza,
Drejtor i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve